



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në zyrën e “Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“MBI AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË,
për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2023”**

TIRANË, MAJ 2024

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1	Përshkrimi i shkurtër i projekt të auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opionioni i auditimit	5-6
II	HYRJA	6-9
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Identifikimi i çështjes	6
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7
5	Kriteret e vlerësimit	7
6	Standardet e auditimit	8
7	Metodat e auditimit	8
8	Dokumentimi i auditimit	9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9-47
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9-10
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	10
2.1	Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	10-17
2.2	Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit	17-26
2.3	Auditimi i llogarive vjetore	26-42
2.4	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm	43-47
IV	REKOMANDIME	47-49
V	ANEKSE	50-51

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, Inspektori mund të vihet në lëvizje bazuar në ankimin me shkrim të çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar. Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është drejtuesi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe i ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur. Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si një institucion i ri kushtetues dhe ligjor, u konstituua në datën 01.02.2020 pas zgjedhjes së z. A. M. në funksionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 2/2020, datë 20.01.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. A.M., Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Bazuar në parashikimet e nenit 197, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, e cila parashikon se: organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit përcaktohen nga Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me Vendimin nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar. Referuar këtij vendimi numri total i personelit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përcaktuar të jetë 93 punonjës për vitet 2021, 2022 dhe 101 punonjës për vitin 2023. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucion i pavarur, financimi i tij kryhet nga buxheti i shtetit, ku për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në masën 136.548 mijë lekë , për vitin 2022 është në masën 155.583 mijë lekë, ndërsa për vitin 2023 është në masën 208.495 mijë lekë.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit të veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar. Në përbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- zbatimi i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre;
- planifikimi i buxhetit, zbatimi i kriterëve në planifikimin e tij, realizimi i planit të buxhetit si edhe shpenzimet administrative;
- zbatimi i dispozitave ligjore për strukturën organizative;
- zbatimi i dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe rakordimi i tyre, opinionimi mbi pasqyrat financiare të vitit 2022;
- funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në terren vijnë si më poshtë:

I. Nga auditimi u konstatua se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me strukturë organizative të paplotësuar referuar vendimit nr.28/2020, datë 18.06.2020 të Kuvendit, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe në nenet 197, pika 4 dhe 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, edhe pse nga ana e strukturave përgjegjëse të ILD -së janë kryer rregullisht procedurat e shpalljes së vendeve vakante.

II. Nga auditimi u konstatua se gjatë zbatimit të buxhetit janë realizuar disa ndryshime tek zërat buxhetorë të lidhura me investimet që sipas periudhave janë si vijon:

- *për vitin 2021* janë planifikuar investimet në vlerën 52,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 23,700 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 14,090 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 59 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 27 %.
- *për vitin 2022* janë planifikuar investimet në vlerën 64,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 16,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 15.391.2 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 96.2 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 24 %.
- *për vitin 2023* janë planifikuar investimet në vlerën 73,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 36,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 5,890.8 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 16.4 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 8 %, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

III. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2023 lidhur me inventarizimin e aktiveve pavarësisht se është miratuar urdhri “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit” për vitin 2021, me nr. 165, datë 24.12.2021 dhe për vitin 2022 me nr. 106 datë 13.12.2022 nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e pikës 73 dhe 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve” pasi nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit përse i përket aktiveve afatgjatë të transferuara nga ish Ministrisë së Integritimit Evropian, të cilat vetëm janë evidentuar në fletët e inventarizimit të përpiluara nga sektori i buxhetit dhe financës, vetëm në sasi, pa vlerë fillestare. Ndërsa nga auditimi u konstatua se në mbyllje të vitit 2023 nuk është realizuar procesi i inventarit fizik sipas afateve ligjore.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

Rekomandimi 1;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për shkak të rëndësisë së posaçme që i njeh ligji për shtetin e së drejtës si dhe për numrit të madh të çështjeve të backlogut të ankesave ende të pashqyrtuara që arrijnë në 2459 ankesa, deri më 31.12.2023, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e strukturës organizative, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe rritjen e performancës në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 2;

Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të merren masat e nevojshme si dhe të ndiqen nga ana e strukturave përgjegjëse të kësaj Zyre, të gjitha fazat e procesit buxhetor, të lidhura me përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit; zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit; si dhe kontrollin, kontabilitetin, raportimin dhe auditimin e buxhetit, me qëllim që devijimet e

treguesve të realizimit faktik të buxhetit kundrejt treguesve të planifikuar të jenë sa më të vogla dhe të argumentuara, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta të zërave të planit buxhetor gjatë vitit.

Rekomandimi 3;

Strukturat përgjegjëse në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të marrin masat e nevojshme për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit fizik periodik. Komisioni i inventarizimit në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të marrë masa mbi inventarizimin e aktiveve afatgjatë të transferuara nga ish Ministria e Integritit Evropian, duke kryer evidentimin e aktiveve në sasi dhe në vlerë evidentohen jo vetëm në sasi, por edhe me vlerë si dhe të vlerësojë gjendjen e tyre në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

I.1.OPINIONI I AUDITIMIT.

Opinion mbi pasqyrat financiare (i pamodifikuar¹)

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*këtu e më poshtë ILD*) për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, dhe opinionin i auditimit jepet për pasqyrat financiare të vitit 2022 të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion: Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Zyrës së ILD-së paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrin rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj. mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare që justifikojnë dhënien e një opinionin të pakualifikuar/pamodifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh vlerën e materialitetit sasior prej 3,112 mijë lekë.

¹- Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli VII pika 4.1 „Një opinion i pamodifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, paraqitur e raportuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, për këto arsye kemi dhënë Opinionin të pamodifikuar të auditimit.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit

Strukturat menaxheriale të ILD-së janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH për auditimin financiar.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare, bazuar mbi rezultatet e auditimit. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së”, në zbatim të programit të auditimit nr.105/2, datë 29.01.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.02.2024 deri më 29.03.2024 në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2021- 31.12.2023 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. E. SH., përgjegjës i grupit të auditimit;
2. T.A, auditues;
3. M N., audituese;
4. E. M, audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrin rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.
- Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet

përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes.

Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit
- Auditimi i llogarive vjetore
- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të ILD-së, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së ILD-së, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;
- Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin dhe Kontrollim Financiar" i ndryshuar,
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021";
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022";
- Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023";
- Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm";

- Vendim nr. 536, datë 25.7.2019, i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo-magjistratë për pozicionin e inspektorit";
- Vendimi nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 dhe dokumentet e saj strategjike si, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan me VKM nr. 823, datë 24.12.2021;
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"; i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e "Udhërrëfyesit të IDI, INTOSAI" Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit";
- Standardet Kombëtare të kontabilitetit.
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022;

7. Metodat e auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetur në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre;
- Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet;
- Raporte dhe informacione, janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të;

8. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Manualit të Auditimit Financiar”, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 17.01.2024, Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat. Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera prej tij. Janë mbajtur 4 (katër) akt-konstatime, konkretisht akt-konstatimi nr.1 “Mbi veprimtarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e dorëzuar zyrtarisht në protokollin e ILD-së me datë 29.03.2024 me nr.172/4 prot., datë 29.03.2024, akt-konstatimi nr.2 “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm” e dorëzuar zyrtarisht në protokollin e ILD-së me datë 29.03.2024 me nr.172/5 prot., datë 29.03.2024, akt-konstatimi nr.3 “Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit e dorëzuar zyrtarisht në protokollin e ILD-së me datë 29.03.2024 me nr.172/6 prot., datë 29.03.2024, akt-konstatimi nr.4 “Mbi pasqyrat financiare” e dorëzuar zyrtarisht në protokollin e ILD-së me datë 29.03.2024 me nr.172/7 prot., datë 29.03.2024.

Gjatë periudhës objekt auditimi janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ)** për Zyrën e ILD-së, *konkretisht:*

- znj.D. P., me vendimin nr. 46, datë 12.07.2021 e Komitetit të Përhershëm të Pranimit me objekt “Për fillimin e marrëdhënieve financiare për znj.D.P.” emërohet Sekretar i Përgjithshëm pranë Zyrës së ILD-së dhe konfirmohet si nëpunës autorizues me shkresën nr. 12784/1 datë 30.07.2021 të MFE.
- znj.V.K., me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse konfirmohet nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit me shkresën 21684/1 prot, datë 01.12.2020 nëpunëse zbatuese e institucionit
- znj.S.R., me detyrë përgjegjës i sektorit të buxhetit dhe financës konfirmohet me shkresën nr. 2205 prot, datë 06.07.2023 të ILD nëpunës zbatues.

Ky raport përfundimtar auditimi u hartua pasi është marrë në shqyrtim edhe konfirmimi i ILD-së protokolluar në KLSH me nr. 105/5 prot., datë 20.05.2024.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, Inspektori mund të vihet në lëvizje bazuar në ankimin me shkrim të çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar. Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrisë të


Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është drejtuesi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe i ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur. Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një institucion i ri kushtetues dhe ligjor, u konstituua në datën 01.02.2020 pas zgjedhjes së z. A. M. në funksionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 2/2020, datë 20.01.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. A.M., Inspektor i Lartë i Drejtësisë". Bazuar në parashikimet e nenit 197, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, e cila parashikon se: organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit përcaktohen nga Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me Vendimin nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar. Referuar këtij vendimi numri total i personelit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përcaktuar të jetë 93 punonjës për vitet 2021, 2022 dhe 101 punonjës për vitet 2023.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit nr.105/2, datë 29.01.2024 të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë u ushtrua auditim financiar për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, sipas drejtimeve:

- 2.1 Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- 2.2 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit
- 2.3 Auditimi i llogarive vjetore
- 2.4 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

2.1 Organika e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:



- Urdhër nr. 119 Prot., datë 12.07.2021 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", ndryshuar me Urdhrat:
- Nr. 119/1 Prot., datë 28.02.2022 "Për një ndryshim në Urdhër nr.119 datë 12.07.2021 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".
- Nr. 57 Prot., datë 07.07.2022 "Për disa ndryshime në Urdhër nr.119 prot., datë 12.07.2021 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar.
- Nr. 52, datë 16.05.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhër nr. 119 prot., datë 12.07.2021 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar.

Rregullimi i brendshëm mbi organizimin, funksionimin, rolet dhe përgjegjësitë brenda Zyrës së ILD janë sanksionuar me aktet e brendshme , përkatësisht: Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e përditësuar me të gjitha ndryshimet si dhe urdhri nr. 56, datë 07.07.2022 "Për miratimin e rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është marrë në analizë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe është miratuar me rezolutë nr.335/3 datë 03.06.2021 "Për vlerësimin e punës së zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", për vitin 2020 (Shkurt-Dhjetor).

-Verifikimi i ankesave, hetimi disiplinor dhe Inspektimet :

Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Referuar veprimtarisë një vjeçare të punës, në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, numri i ankesave të paraqitura gjatë **periudhës janar - dhjetor 2021**, ka qenë i lartë. Numri i lartë është tregues për besimin që kanë qytetarët tek institucioni, sepse i drejtohen masivisht. Çdo ankesë ka një ecure të përcaktuar ligjërisht, që nis me shqyrtimin fillestar, verifikimin e më pas hetimin ose arkivimin, ecure që kërkon kohë dhe kapacitet dhe për periudhën e këtij raportimit janë **1719 ankesa të shqyrtuara**.

Gjatë këtij viti janë depozituar 1257 ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:

- 1210 ankesa të depozituara nga persona fizikë ose individë;
- 28 ankesa të depozituara nga organe publike;
- 12 ankesa të depozituara nga organizata të shoqërisë civile;
- 7 ankesa të depozituara nga media;

Duke marrë në konsideratë se me raportin e vitit 2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka mbyllur vitin me 2870 ankesa në proces, shqyrtimi i të cilave ka vijuar edhe gjatë vitit 2021, si shtesë

ndaj numrit prej 1257 ankesave të depozituara për vitin 2021, totali i ankesave që kanë qenë objekt shqyrtimi është 4127 ankesa. Nga 4127, janë shqyrtuar 1719 ankesa, 427 prej të cilave janë pjesë e fondit të mbartur të ish- KLD-së apo të atyre të grumbulluara gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa 1292 rezultojnë të jenë trajtuar nga ankesat e depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në ushtrim të kompetencave Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 1719 ankesa, nga numri totali prej 4127 ankesave. Rezultati i shqyrtimit të ankesave është:

- 990 vendime për arkivimin e 1433 ankesave;
- 197 vendime për verifikimin e 270 ankesave, të cilat do të vijojnë për vitin 2022; □ 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor për 31 subjekte të hetimit disiplinor; □ 17 kërkesa për procedim disiplinor pranë Këshillave.

*Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, **viti 2021 mbyllet me 2678 ankesa në proces, që janë mbartur për trajtim në vitin 2022, 1677 prej tyre janë pjesë e fondit të kaluar nga ish-KLD-ja apo të atyre të grumbulluara gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.***

-Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve të hetimit disiplinor, gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje bazuar në:

- a) ankimin me shkrim të çdo personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar,
- b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;
- c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm Drejtësisë;
- ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore; dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.

-Arkivimi dhe verifikimi i ankesave :

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "dh", të paragrafit 1, të nenit 120, të ligjit nr. 96/2016. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe brenda tre muajve nga depozitimi i ankesës vendos për arkivimin e ankesës, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen. Sipas nenit 122, të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke:

- kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar;
- marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Në përmbushje të këtyre parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 1719 ankesa, për të cilat ka miratuar 990 vendime për arkivim, prej të cilave 785 vendime janë marrë pas shqyrtimit fillestar, dhe 205 vendime arkivimi janë marrë pasi në përfundim të verifikimit të ankesës, është konstatuar se nuk ka fakte të mjaftueshme për të filluar fillimin. Ndërsa për 197 vendime për verifikimin e ankesave, gjatë periudhës së raportimit, shqyrtimi i tyre vijon të mbetet në proces, të dhënat e të cilave do të përditësohen në raportin vjetor pasardhës. Nga shqyrtimi i ankesave të depozituara, për 90 prej rasteve ka rezultuar se një ankues ka paraqitur më shumë se një ankesë për të njëjtat fakte apo për të njëjtin magjistrat. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për këto raste ka vendosur bashkimin e ankesave.

Nisur nga shqyrtimi i ankesave, rezulton se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit ndahen si më poshtë:

- Ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- Pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve;
- Shkelje procedurale nga ana e magjistratëve;

Shkaqet të cilat kanë çuar në arkivimin e një numri të madh ankesash janë objekt i analizave të vazhdueshme nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në funksion të hartimit të politikave të brendshme të punës, jo vetëm për të përmirësuar shërbimin në funksion të interesit publik dhe transparencës, por edhe zhvillimin e politikave ndërgjegjësuese në këtë drejtim.

-Ankime kundër vendimeve të arkivimit:

Bazuar në nenin 119, pika 4, dhe nenit 122, pika 5, e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës. Në total vendimet e arkivimit kanë qenë 990. Kundër vendimeve të arkivimit janë depozituar pranë këshillave, sa më poshtë:

- 80 ankime ndaj 785 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 4 ankime ndaj 205 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;

Sikurse evidentohet më sipër rezulton një numër i ulët i ankimeve, në këshilla ndaj vendimeve të arkivimit. Nga 990 vendime arkivimi janë ankimuar vetëm 84, ose thënë në përqindje, janë ankimuar 8.4% e vendimeve të arkivimit.

- 84 ankime rezultojnë 0 vendime të rikthyera për shqyrtim nga Këshillat;

Nga 84 vendime arkivimi të ankimuar, rezulton se për të gjitha rastet këshillat kanë vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është kthyer për rishqyrtim.

-Hetimet Disiplinore :

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat

e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi konstatoi se ekzistonin dyshime të arsyeshme, ka miratuar 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 28 magjistratëve dhe 3 anëtarëve të këshillit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të hetimit disiplinor, analizës ligjore të fakteve të pranura të cilat mbështetin përfundimin se shkelja disiplinore është kryer, për 17 magjistratë ka paraqitur kërkesën për procedim disiplinor pranë këshillave. Ndërsa për 14 subjektet e tjerë të hetimit disiplinor rezultatet e hetimit janë sa vijon:

- Për 1 magjistrat është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;
- Për 4 magjistratë është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të: të mbarimit të statusit të magjistratit, vlerësimit të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara;
- Për 9 subjekte të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në faza të ndryshme sipas kërkesave të ligjit për zhvillimin e tyre.

Fillimi i hetimit disiplinor, për 31 subjekte të hetimit disiplinor ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer nga subjekti. Shkeljet disiplinore për të cilat, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor, renditen në:

- shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit
- shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit; shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale me vendim të formës së prerë, që sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranura nga gjykata.

Nga përfundimi i hetimit disiplinor gjatë vitit 2021, për 21 magjistratë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar fillimin e procedimit disiplinor për 17 magjistratë, ose për 81% të rasteve të hetuara, ndërsa për 4 magjistratë ka vendosur mbylljen e hetimit disiplinor.

-Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit, çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

Gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 17 magjistratë, për 11 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 6 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në

shkeljet disiplinore të parashikuar nga nenet 102-104 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

-Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve :

Gjatë periudhës janar 2021-dhjetor 2021, janë kryer dhe ndjekur trajnime me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive profesionale, me fokus të veçantë njësinë e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve për zhvillimin profesional, në përmbushjen sa më eficiente të detyrave funksionale. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga krijimi i institucionit. Zhvillimi i këtyre trajnimeve në vazhdimësi, shihet si një element shumë i rëndësishëm për rritjen e performancës, jo vetëm të njësisë së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve, por edhe të gjithë stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Konkretisht Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, deri tani ka patur bashkëpunime me organizata ndërkombëtare si TAIEX, OPDAT, CEPEJ, Misioni EURALIUS V..etj, dhe me ASPA-n.

Në dhjetor 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë (ILD) u pranua me statusin e vendit vëzhgues në gjirin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, rrjet i cili është krijuar në 2017 si iniciativë e Francës.

Prej 19 Tetorit 2023, anëtarët e Rrjetit vendosën të pranonin Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë, si anëtar me të drejta të plota.

Që prej dhjetorit 2021, ILD është angazhuar aktivisht në çdo aktivitet të RESIJ, si në vendet anëtare ashtu edhe jashtë Unionit.

Me shkresën nr.1311/2 Prot., datë 20.07.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit është dërguar rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë datë 04.07.2022, "Për vlerësimin e veprimtarisë së zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", për vitin 2021.

-Verifikimi i ankesave, hetimi disiplinor dhe Inspektimet:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Referuar veprimtarisë e në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2022, vihet re një numër i lartë ankesash të paraqitura.

Gjatë këtij viti janë depozituar 789 ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:

- 756 ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- 33 ankesa të depozituara nga persona juridikë;

Viti 2021 është mbyllur me 2678 ankesa në proces. Shqyrtimi i tyre ka vijuar edhe gjatë vitit 2022, si shtesë ndaj numrit prej 789 ankesave të reja të depozituara në vitin 2022, duke numëruar në total 3467 ankesa objekt shqyrtimi. Nga 3467 ankesa objekt shqyrtimit gjatë vitit 2022, janë shqyrtuar 1715 ankesa.

-Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "dh", të paragrafit 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe brenda tre muajve nga depozitimi i ankesës vendoset për arkivimin e saj, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen. Sipas nenit 122 të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar apo duke marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Në përmbushje të këtyre parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 1715 ankesa, për të cilat ka miratuar 1234 vendime:

- 862 vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të 1220 ankesave;
- 344 vendime për arkivimin pas verifikimit të 425 ankesave; □ 28 vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit të 70 ankesave.

- Hetimet disiplinore:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi konstatoi ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme, ka miratuar 28 vendime për hetimin disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 41 magjistratëve.

Hetimi disiplinor për 3 subjekte ka filluar me iniciativë, për 38 subjekte mbi bazë ankese.

- Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit :

Bazuar në nenin 119, pika 4 dhe nenit 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës. Neni 62, pika 13 dhe neni 160, pika 13 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikojnë respektivisht të drejtën për ankim ndaj vendimeve të arkivimit ose të pushimit/mbylljes së hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve, që ngrihen respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendimet e Komisionit të Përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.

Gjatë vitit 2022 ILD, ka marrë 1224 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme, nga ku rezulton se kundër vendimeve janë depozituar:

- 83 ankime ndaj 862 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;

- 15 ankime ndaj 344 vendimeve të arkivimit pas verifikimit; □ 1 ankim ndaj 18 vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor.

Nga 1224 vendime janë ankimuar vetëm 98 vendime arkivimi, ose thënë në përqindje, janë ankimuar 8% e vendimeve të arkivimit. Ndërsa për 18 vendime për mbyllje të hetimit disiplinor rezulton vetëm 1 vendim i ankimuar, ose 5.5% e vendimeve të hetimit të ankimuar. Nga të gjitha ankimet e paraqitura rezultojnë 0 vendime të kthyer për shqyrtim.

-Aktualisht në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aplikohet një sistem elektronik i brendshëm, i emërtuar “Sistemi i Menaxhimit të Ankesave dhe Dokumenteve” (SMAD), përmes të cilit administrohet menaxhimi i ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore të trajtuara dhe administruara nga institucioni.

-**Sistemi SMAD**, aksesohet përmes kredencialeve (username dhe password) sipas kufizimeve të vendosura lidhur me autorizimin e përdoruesve, roleve të tyre në sistem dhe nivelit të aksesit për çdo kategori përdoruesi. Rregullat për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi, janë miratuar me Urdhrin Nr. 59, datë 15.07.2022, “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Ankesave dhe Dokumenteve të Procedurës Hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

-Në kuadër të transparencës ndaj publikut, në faqen zyrtare (web) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë publikuar: Raportet e punës 6- mujore të veprimtarisë së kryer nga Zyra e ILD-së, si dhe Raporti vjetor i paraqitur dhe pranë Kuvendit të RSH. Gjithashtu, në kuadër të informimit me punën që kryhet në institucion, çdo muaj botohet Buletini i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përmbajtje të të cilit jepen informacionet në lidhje me ankesat, aktivitetet dhe temat më kryesore dhe me interes të zhvilluara përgjatë një muaji.

Me shkresën nr.1174/2 Prot., datë 12.07.2023 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Shërbimi Legjislativ Shërbimi Juridik ka dërguar rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”.

Nga ana e strukturës së ILD-së të konsolidohen më tej mekanizmat institucionale për përmbushjen e objektivit konform legjislacionit në fuqi.

2.2. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit

PBA 2022-2024, Buxheti 2021:

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2021:

Me ligjin nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2021, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2021, janë miratuar në një program buxhetor;

- 03320–Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Fondi i rakorduar për programin buxhetor 03320– Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021 ishte 260,000mijë lekë.

Me daljen e Udhëzimit nr. 8 datë 26.02.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka urdhëruar ngritur e Urdhërit me nr. 71, datë 23.03.2021 mbi Ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të

Programit Buxhetor. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 03.03.2021 mbi “Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2022- 2024” është parashikuar një buxhet në total prej 204,800 mijë lekë, nga i cili:

- Shpenzime Korrente 202,800 mijë lekë;
- Shpenzime Kapitale 2,000 mijë lekë;

Më datë 23.04.2021, me nr. 2153 prot., Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka nisur shkresën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kërkesat buxhetore për PBA-s 2022- 2024 fazën strategjike.

Referuar Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 09.07.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, më datë 31.08.2021, me nr. 3383/1 prot., Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka nisur shkresën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kërkesat buxhetore për PBA-në 2022- 2024 fazën teknike.

Tavanet për PBA 2022 – 2024 dhe kërkesat shtesë FI/FII në 000/lekë

Llogaria	Emërtimi	PBA 2022-2024 Faza e I		PBA 2022-2024 Faza e II	
		Sipas tavanëve	Kërkesa shtesë	Sipas tavanëve	Kërkesa shtesë
600-601	Paga Sigurime	180,000		180,000	
602-606	Shpenzime të tjera korrente	22,800	15,200	22,800	15,200
I	Shpenzime Korrente	202,800	15,200	202,800	15,200
230-231	Rikonstruksion dhe përshtatje e zyrave në godinën e ILD-së	0	79,050	0	108,088
	Furnizim dhe vendosje pajisje për dhomën e serverave	0	11,110	0	0
	Blerje pajisje zyre		10,000	3,000	7,000
	Pajisje informatike	2,000		1,000	
II	Shpenzime Kapitale	2,000	100,160	4,000	115,088
I+II Totali i Shpenzimeve		204,800	115,360	206,800	130,288

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Totali i shpenzimeve për fazën e 2-të të PBA-së është përcaktuar në vlerën 337,088 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente në vlerën 218,000 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 119,088 mijë lekë.

- Kërkesat shtesë në këtë fazë të PBA-së 2022-2024, janë përgatitur në zbatim të Udhëzimit Plotësues dhe përmbajnë formatet standarde të miratuara. Buxheti shtesë i kërkuar është në shumën 130,288 mijë lekë (paraqitur në tabelën e mësipërme), ku argumentimi i tyre sipas llogarive rezulton si më poshtë:
 - *Sa i përket shpenzimeve korrente;*
 - janë marrë parasysh, kosto financiare vjetore për shpenzimet e personelit për paga e sigurime, me një total prej 180,000 mijë lekë,

- si dhe kosto për mbulimin e shpenzimeve operative për aktivitetin e institucionit gjatë vitit buxhetor në shumën 38,000 mijë lekë, të detajuar në zëra analitikë, sipas natyrës së shpenzimeve.
- *Sa i përket grupit të shpenzimeve kapitale;*
- “Rikonstruksioni dhe përshtatja e zyrave në godinën e ILD-së”, projekt me vlerë të plotë 108,088,000 lekë, realizimi i të cilit do të mundësojë ngritjen e infrastrukturës bazë, nëpërmjet rikonstruksionit të godinës aktuale, riparimit të dëmtimeve pas zhvendosjes së dy institucioneve të tjera, ku janë dëmtuar ose çmontuar sisteme dhe rrjete të godinës, përshtatjes së katit I i parashikuar si sallë mbledhjesh, në zyra për stafin, pasi ato ekzistuese janë të pamjaftueshme. Në Formularin F-2 të propozimit të projektit FPPI bashkëlidhur, përfshihet kosto e plotë e investimeve që do të duhen për realizimin e tij në të gjithë komponentët (zbatimi i projektit, mbikqyrja e punimeve dhe kolaudimi i objektit). Për financimin e këtij projekti, është miratuar fondi prej 32,000 mijë lekë në buxhetin e vitit aktual; në tavanet e PBA 2022-2024 nuk është parashikuar fond për përfundimin e plotë të tij.
- “Blerje pajisje zyre”, në vlerën 10 milionë lekë, të përlogaritur mbi bazën e numrit të posteve të punës dhe zyrave, të përcaktuara sipas aktiviteteteve dhe veprimtarive të institucionit. (Formulari F-2 i propozimit të projektit FPPI bashkëlidhur). Në PBA 2022-2024 është parashikuar fondi për mbulimin pjesor të nevojave në këtë zë investimesh, në vlerën 3 milionë lekë.
- “Blerje pajisje informatike”, në vlerën 1 milionë lekë parashikuar për tu realizuar brenda tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2022-2024.

Realizimi i planit të buxhetit:

Raportet e monitorimit:

Për vitin 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka paraqitur dhe dërguar 3 raporte monitorimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme së Buxhetit:

- ✓ 4 mujorin e parë të vitit 2021 datë 19.05.2021, me nr. 2443 prot.
- ✓ 8 mujorin e vitit 2021 datë 16.09.2021 me nr. 3608 prot. dhe
- ✓ 12 mujorin e vitit 2021 datë 15.02.2022 me nr. 376 prot.

Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik.

Programi – 03320 Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

në 000/lekë

Art.	Emërtimi	Fakti vitit paraardhës Viti 2020	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	%
			Plani fillestar Viti 2021	Plani rishikuar viti 2021	Realizimi Vjetor	Realizimit
600	Paga	25,790	160,000	90,600	87,929	97.05%
601	Sigurime Shoqërore	3,586	20,000	13,500	13,036	96.56%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,798	28,000	26,770	21,269	79.45%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	0	150	1380	224	16.23%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	34,174	208,150	132,250	122,458	92.60%

231	Kapitale të Trupëzuara	6,061	52,000	23,700	14,090	59.45%
Nën - Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	6,061	52,000	23,700	14,090	59.45%
Totali	Shpenzime Kapitale	6,061	52,000	23,700	14,090	59.45%
Totali		40,235	260,150	155,950	136,548	87.56%

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Buxheti i rishikuar vjetor për programin 03320 Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas ndryshimeve është **155,950 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **136,548 mijë lekë** ose në masën **87.56 %**.

Investimet

Projekte me financim të brendshëm dhe me financim të huaj

000/lekë

Llogaria ekonomike	Kodi i Projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti fillestar në 1 janar (lekë)	Plani i rishikuar	Realizimi
231	M630001	Blerje pajisje zyre	10,000	7,300	198
231	M630020	Blerje automjeti	7,000	7,080	7,080
231	M630008	Rikonstruksion ambientesh	32,000	3,960	3,960
231	M630013	Pajisje kompjuterike	3,000	2,860	2,852.4
231	M630013	Furnizim dhe vendosje pajisje përdhomën e serverave	-	2,500	-
		Totali investimeve	52,000	23,700	14,090.4

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Investimet për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 52,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 23,700 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 14,090 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 59 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 27 %.

PBA 2023- 2025, Buxheti 2022

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2022:

Me ligjin nr. 115/2021, datë 25.11.2021“Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Inspektori i Lartë i Drejtësisë” në vlerën 266,800 mijë lekë. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2022, janë miratuar në një program buxhetor;

- 03320–Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Me daljen e Udhëzimit nr. 09 datë 28.02.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerr Urdhërin me nr. 27, datë 18.03.2022 mbi “Ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor”.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 02.03.2022 mbi “Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2023- 2025” është parashikuar një buxhet në total prej 252,000 mijë lekë, nga i cili:

- Shpenzime Korrente 200,000 mijë lekë;
- Shpenzime Kapitale 52,000 mijë lekë;

Më datë 29.04.2022, me nr. 547/2 prot., Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka nisur shkresën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kërkesat buxhetore për PBA 2023- 2025 fazën strategjike.

Referuar Udhëzimit Plotësues nr. 22 datë 08.07.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, detajimi i buxhetit në nivel llogarie për fazën e I-rë dhe të II-të të PBA-së 2023-2025, është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përkatësisht me shkresat nr. 547/2, datë 29.04.2022 dhe nr. 2244/1, datë 31.08.2022 “Kërkesat buxhetore për periudhën 2023-2025”, paraqitet si më poshtë:

Tavanet për PBA 2023 – 2025 dhe kërkesat shtesë FI/FII në 000/lekë

Llogaria	Emërtimi	PBA 2023-2025 Faza e I		PBA 2023-2025 Faza e II	
		Sipas tavaneve	Kërkesa shtesë	Sipas tavaneve	Kërkesa shtesë
600-601	Paga Sigurime	180,000	34,000	180,000	15,000
602-606	Shpenzime të tjera korrente	20,000	15,500	20,000	15,000
I	Shpenzime Korrente	200,000	49,500	200,000	30,000
230-231	Rikonstruksion dhe përshtatje e zyrave në godinën e ILD-së	50,000	-	50,000	14,030
	Blerje licencash për zyrën e ILD	-	4,619	-	4,619
	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit SMAD	-	3,700	-	3,700
	Furnizim dhe vendosje pajisje për dhomën e serverave	-	3,000	-	3,000
	Blerje pajisje zyre	-	10,000	-	10,000
	Pajisje informatike	2,000	-	2,000	-
II	Shpenzime Kapitale	52,000	21,319	52,000	35,349
I+II Totali i Shpenzimeve		252,000	70,819	252,000	65,349

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Totali i shpenzimeve për fazën e 2-të të PBA-së është përcaktuar në vlerën 317,349 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente në vlerën 230,000 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 87,349 mijë lekë.

➤ Kërkesat shtesë në këtë fazë të PBA-së 2023-2025, janë përgatitur në zbatim të Udhëzimit Plotësues dhe përmbajnë formatet standarde të miratuara. Buxheti shtesë i kërkuar është në shumën 65,349 mijë lekë (paraqitur në tabelën e mësipërme), ku argumentimi i tyre sipas llogarive rezulton si më poshtë:

▪ *Sa i përket shpenzimeve korrente;*

- Kërkesat shtesë në fazën e II-të të PBA 2023-2025, janë bërë me arsyetimin se ILD është në përgatitje të propozimit për ndryshimin e strukturës organizative me një efekt vjetor financiar prej 15,000 mijë lekë. Shpenzimet për paga e sigurime, sëbashku me efektin e ndryshimeve për tu propozuar në strukturën organizative të ILD, përlllogaritet në shumën prej 195,000 mijë lekë.
- Gjithashtu, për realizimin e aktiviteteve/masave në funksion të mbarëvajtjes së institucionit gjatë vitit të ardhshëm është përlllogaritur një kosto në zërat e shpenzimeve për mallra e shërbime prej 35,000 mijë lekë.

▪ *Sa i përket shpenzimeve kapitale;*

- *Për përfundimin e punimeve të zbatimit të projektit të rikonstruksionit të ambienteve të godinës së ILD, ishte parashikuar fondi prej 50,000 mijë lekë për vitin 2023. Mbështetur në Aktin Normativ nr.10, datë 18.05.2022 “Për kompensim financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë...”, u bë rivlerësimi i preventivit dhe rezultoi me një shtesë prej 14,030 mijë lekë.*
- *Nevoja për instalimin e 77 licensave për përdorimin e sistemit të regjistrimit dhe menaxhimit të dokumentave dhe ankesave si dhe sigurimin e serverave, me një kosto financiare prej 4,600 mijë lekë.*
- *Për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit SMAD, në vlerën 3,700 mijë lekë.*
- *Furnizim dhe vendosje pajisje për dhomën e serverave, në vlerën 3,000 mijë lekë.*
- *Blerje pajisje zyre, i përlogaritur mbi bazën e numrit të posteve të punës, zyrave dhe ambienteve të përcaktuar në projektin e rikonstruksionit të godinës, në vlerën prej 10,000 mijë lekë.*

Ndryshime në buxhet:

Në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti i ILD gjatë vitit 2022:

- Me shkresën nr.3957, datë 01.03.2022 të MFE, është përcjellë fondi i veçantë në dispozicion të ILD për vitin 2022 në shumën 300 mijë lekë.
- Me aktin normativ nr.3 datë 12.03.2022, buxheti i ILD është pakësuar në grupin e shpenzimeve korrente, në shumën 4,500 mijë lekë për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante dhe 1,200 mijë lekë në zërin 602.
- Me shkresën 4205/1 datë 04.04.2022, MFE ka miratuar transferimin e fondeve nga llogaria 600-601 në 602, në shumën prej 5,000 mijë lekë.
- Me shkresën 7033/1 datë 04.05.2022, MFE ka miratuar transferimin e fondeve në shumën 1,000 mijë lekë nga “pajisje zyre” M630001 në “pajisje informatike” M630013.
- Me shkresën 4526/1 datë 11.05.2022, MFE ka miratuar transferimin e fondeve prej 2,000 mijë lekë për blerjen e licensave për përdoruesit e sistemit SMAD.
- Me shkresën 13142/1 datë 12.07.2022, MFE ka miratuar transferimin e fondeve në shumën 10,000 mijë lekë nga zëri 600 në zërin 602.
- Me aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022, është pakësuar fondi në vlerën 48,000 mijë lekë për projektin “rikonstruksion ambientesh”.
- Bazuar në VKM nr.898, datë 29.12.2022, është transferuar fondi prej 950 mijë lekë nga zëri 600 në zërin 606, për pagesat e mbështetjes financiare të punonjësve për zbutjen e impaktit të krizës.

Realizimi i planit të buxhetit:

Për vitin 2022, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes Qëndrore” dhe të Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 376/1.prot datë 12.05.2022.

- Raporti i monitorimit 8–muajor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 2474.prot datë 15.09.2022.

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 661 prot. datë 27.02.2023.

Për sa i përket realizimit në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 03320 “Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Raporti i shpenzimeve të programit:

në 000/lekë

	Emërtimi	Fakti vitit 2021	Plani Fillestar 2022	Plani i rishikuar 2022	Realizimi 2022	% e realizimit
Llog		1	2	3	4	
600	Paga	87,929	160,000	99,550	98,135	98.57%
601	Sigurime Shoqërore	13,036	20,000	15,000	14,511	96.74%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	21,269	21,570	34,413	26,306	76.44%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	224	1,230	2,480	1,240	50%
I	Totali i Shpenzimeve Korente	122,458	202,800	151,443	140,192	92.57%
231	Kapitale të Trupëzuar	14,090	64,000	16,000	15,391	96.19%
II	Totali i Shpenzimeve Kapitale	14,090	64,000	16,000	15,391	96.19%
I+II	Totali i shpenzimeve korrente dhe kapitale	136,548	266,800	167,443	155,583	92.91%

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Buxheti i rishikuar vjetor për programin 03320 Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas ndryshimeve është **167,443 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **155,583 mijë lekë** ose në masën **92.91 %**.

Investimet

Projekte me financim të brendshëm dhe me financim të huaj

në 000/lekë

Llogaria ekonomike	Kodi i Projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti fillestar në 1 janar (lekë)	Plani i rishikuar	Realizimi
231	M630001	Blerje pajisje zyre	3,000	-	-
231	M630008	Rikonstruksion ambientesh	60,000	12,000	11,657.4
231	M630013	Pajisje kompjuterike	1,000	2,000	1,753.2
231	18AB202	Blerje licensash	-	2,000	1,980.5
		Totali i investimeve	64,000	16,000	15,391.2

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Investimet për vitin 2022 janë planifikuar në vlerën 64,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 16,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 15.391.2 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 96.2 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 24 %.

PBA 2024- 2026, Buxheti 2023

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2023:

Me ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Inspektori i Lartë i Drejtësisë” në vlerën 288,400 mijë lekë. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar në një program buxhetor;

- 03320–Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Me daljen e Udhëzimit nr. 5 datë 28.02.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerr Urdhërin me nr. 45, datë 12.04.2023 ndryshuar me Urdhërin nr.45/1 datë 04.07.2023, mbi “Ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor”.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 05.04.2023 mbi “Miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2024-2026”, është parashikuar një buxhet në total prej 217,400 mijë lekë, nga i cili:

- Shpenzime Korrente 215,400 mijë lekë;
- Shpenzime Kapitale 2,000 mijëlekë;

Më datë 28.04.2022, me nr.184/1 prot., Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka nisur shkresën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kërkesat buxhetore për PBA 2024-2026 fazën strategjike.

Referuar Udhëzimit Plotësues nr. 22 datë 07.07.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, detajimi i buxhetit në nivel llogarie për fazën e I-rë dhe të II-të të PBA-së 2024-2026, është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përkatësisht me shkresat nr.184/1, datë 28.04.2023 dhe nr.2516/1, datë 31.08.2023 “Kërkesat buxhetore për periudhën 2024-2026”, paraqitet si më poshtë:

Tavanet për PBA 2024 – 2026 dhe kërkesat shtesë FI/FII

000/lekë

Llogaria	Emërtimi	PBA 2024-2026 Faza e I		PBA 2024-2026 Faza e II	
		Sipas taveve	Kërkesa shtesë	Sipas taveve	Kërkesa shtesë
600-601	Paga Sigurime	190,400	8,900	190,400	71,350
602-606	Shpenzime të tjera korrente	25,000	7,000	25,000	11,800
I	Shpenzime Korrente	215,000	15,900	215,000	83,150
	Rikonstruksioni godinës ILD			-	62,600
	Blerje automjetesh			-	15,000
	Zhvillimi dhe përmirësimi SMAD	-	3,700	-	-
	Furnizim dhe vendosje pajisje për dhomën e serverave	-	3,000	-	-
	Blerje pajisje zyre	-	22,340	-	22,300
	Pajisje informatike	2,000	-	2,000	3,000
II	Shpenzime Kapitale	2,000	29,040	2,000	102,900
I+II Totali i Shpenzimeve		217,400	44,940	217,400	186,050

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Totali i shpenzimeve për fazën e 2-të të PBA-së është përcaktuar në vlerën 403,450 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente në vlerën 298,550 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në vlerën 104,900 mijë lekë.

Referuar tabelës më sipër vihet re se kërkesat shtesë nga faza e parë në fazën e dytë kanë një rritje të konsiderueshme prej 141,110 mijë lekë më shumë (F2 186,050 mijë – F1 44,940 mijë). Nga dokumentacioni/informacioni administruar nga ana e grupit të auditimit, konstatohet se kjo rritje vjen kryesisht, për arsytet sa më poshtë:

- Për shkak të ndryshimeve ligjore të miratuara për pagat e pozicioneve të emërtesës së ILD, përlllogaritet një kosto financiare vjetore prej 261,750 mijë lekë, ose 71,350 mijë lekë më shumë.
- Për përfundimin e rikonstruksionit të godinës së ILD, është i nevojshëm fondi prej 62,600 mijë lekë, ku pjesa e pa mbuluar me fonde buxhetore është 39,200 mijë lekë, shtesa e volumit të zërave të punimeve është 23,300 mijë lekë dhe realizimi i kolaudimit është 120 mijë lekë.
- Kërkesat e institucionit në bazë të nevojave të tij në PBA 2021-2023 ishin për blerjen e tre automjeteve, por fondi i miratuar për këtë zë ishte i pamjaftueshëm dhe u realizua blerja e vetëm një automjeti.

Kërkesat shtesë në këtë fazë të PBA-së 2024-2026, janë përgatitur në zbatim të Udhëzimit Plotësues dhe përmbajnë formatet standarde të miratuara.

Ndryshime në buxhet:

Në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti i ILD-së gjatë vitit 2023:

Në zërat 600-601:

- Në zbatim të ligjit 33/2023, VKM nr.325 dhe nr.326 dt.31.05.2023, nga Ministria e Financave janë akorduan fonde shtesë për përballimin e efektit të rritjes së pagave të magjistratëve, të nëpunësve civil dhe atyre mbështetës me një total prej rreth 36,100 mijë lekë.
- Në zbatim të VKM nr.929 dt.17.11.2010, të ndryshuar dhe VKM nr.795 dt.28.12.2023, nga MF është akorduar fondi për shpërblimet e punonjësve për vitin 2023, në shumën totale prej 1,100 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, mosplotësimi i vendeve vakante për pozicionet “Inspektor” krijoi fonde të lira në zërat “Paga” e “Sigurime”, duke u pakësuar me 43,500 mijë lekë.

Në zërat 602-606:

- Në zërin 602, për vitin 2023, është krijuar fondi shtesë prej 10,500 mijë lekë, nga i cili 9,400 mijë lekë shtesë nëpërmjet transferimit nga fondet e kursyera në zërat “Paga” e “Sigurime”, dhe 1,100 mijë lekë shtesë e miratuar me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023.
- Me shkresën e MFE nr.4525 datë 07.03.2023 është përcjellë fondi i veçantë i miratuar për vitin 2023 në zërin 606 në shumën 300 mijë lekë.
- Gjithashtu, po në zërin 606, në zbatim të udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2023 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 5, është shtuar fondi prej 168.48 mijë lekë, me transferim nga zëri 600, të miratuar me shkresën e MFE nr.6521/1 datë 19.04.2023.

Realizimi i planit të buxhetit:

Për vitin 2023, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e

monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes Qendrore” dhe të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4-mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 1632.prot datë 16.05.2023.

- Raporti i monitorimit 8-mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 2790.prot datë 27.09.2023.

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 520.prot datë 19.02.2024.

Për sa i përket realizimit në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 03320 “Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Raporti i shpenzimeve të programit:

në 000/lekë

Llog	Emërtimi	Fakti vitit 2022	Plani Fillestar 2023	Plani i rishikuar 2023	Realizimi 2023	% e realizimit
		1	2	3	4	t
600	Paga	98,135	168,700	152,056	149,375	98.24%
601	Sigurime Shoqërore	14,511	21,700	21,600	20,459	94.72%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	26,306	23,770	34,270	32,322	94.32%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	1,240	1,230	1,198	447	37.28%
I	Totali i Shpenzimeve Korente	140,192	215,400	209,124	202,604	96.88%
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	5,000	4,937	98.74%
231	Kapitale të Trupëzuar	15,391	73,000	31,000	954	3.08%
II	Totali i Shpenzimeve Kapitale	15,391	73,000	36,000	5,891	16.36%
I+II	Totali i shpenzimeve korrente dhe kapitale	155,583	288,400	245,124	208,495	85.06%

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Buxheti i rishikuar vjetor për programin 03320 Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas ndryshimeve është **245,124 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **208,495 mijë lekë** ose realizuar në masën **85.06 %**.

Investimet

në 000/lekë

Llogaria ekonomike	Kodi i Projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti fillestar në 1 janar (lekë)	Plani i rishikuar	Realizimi
231	M630008	Rikonstruksion ambientesh	67,000	30,000	-
231	M630013	Pajisje kompjuterike	1,000	1,000	954
230	18AB202	Blerje licensash	5,000	5,000	4,936.8
		Totali i investimeve	73,000	36,000	5,890.8

Burimi: Të dhëna të ILD të përpunuar nga audituesit e KLSH.

Investimet për vitin 2023 janë planifikuar në vlerën 73,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 36,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 5,890.8 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 16.4 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 8 %.

2.3 Auditimi i llogarive vjetore:

Saktësia dhe rregullshmëria e pasqyrave financiare vjetore

Pasqyra financiare viti 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 " Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ".

Pasqyrat Financiare të raportimit për vitin 2021, përmbajnë:

- Pozicioni Financiar (Formati Nr.1).
- Performanca Financiare (Formati nr.2).
- Pasqyra e Cash Flow (Formati nr.3).
- Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto (Formati nr.4).
- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. (Formatet nr. 5).

Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore, të cilat janë:

- Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre (Formati nr.6).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (Formati nr.7).
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr.8).

Veprimet për vitin 2021 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2021 i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Degës së Thesarit me shkresën nr. 683 prot., datë 25.03.2022, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, në referim të paragrafit nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018. Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2021, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	600,407,728.55	26,667,875.10

2		I.Aktivet Afat shkurtra	26,476,744.77	8,696,158.81
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	-	-
4		2.Gjendje Inventari qarkullues	4,910,536.77	1,389,974.81
5	31	Materiale	4,122,516.89	1,294,778.81
6	32	Inventar I imet	788,019.88	95,196.00
7		3.Llogari te Arkëtueshme	10,188,752.00	7,306,184.00
8	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	10,188,752.00	7,306,184.00
9	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike		
10	49	Shuma te parashikuara përzhvlerësim(-)		
11		4.Te tjera aktive afatshkurtra	11,377,456.00	-
12	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	11,377,456.00	-
13		II.Aktivet Afat gjata	573,930,983.78	17,971,716.29
14	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	-	-
15	21	2.Aktive Afatgjata materiale	569,860,983.78	17,861,716.29
16	210	Toka, Troje, Terrene		
17	211	Pyje, Plantacione		
18	212	Ndërtesa e Konstruksione	547,925,100.00	
19	215	Mjete Transporti	7,316,053.12	1,622,566.40
20	218	Inventar ekonomik	14,619,830.66	16,239,149.89
21		4.Investime	4,070,000.00	110,000.00
22	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		-
23	231	Për Aktive Afatgjata materiale	4,070,000.00	110,000.00

Burimi: Të dhëna të ILD

Zëri Aktive

Shuma e aktivitet të pasqyrës financiare pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitet të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2021,rezulton se totali i aktivitet me 31.12.2021 paraqitet me vlerën 600,407,728.55 lekë dhe se "Aktive Afatgjata", zënë rreth 86 % të vlerës totale të aktivitet ndërsa Aktivitet Afatshkurtra zënë 4 % të vlerës totale. Aktivitet Afatgjata në krahasim me vitin 2020, janë shtuar në vlerën 555,959,267 lekë ndërsa, Aktivitet Afatshkurtra janë shtuar në vlerën 17,780,585.9 lekë.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive "Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre" me "Gjendje inventarit qarkullues", "Llogarive të arkëtueshme" dhe "Të tjera aktive afashkurtra"

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

❖ Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 4,910,536.77 lekë.

Totali i llogarisë "Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një shtim me 3,520,561.96lekë nga viti i shkuar. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së materialeve" në Pasqyrën e performancës, e cila rezulton në vlerën 3,520,561.96 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 4,122,516.89 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 2,827,738.08 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2021, materiale kancelarie si: letër, tonera, furnizime e materiale të tjera zyre e të përgjithshme, etj.
- Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 788,019.88 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 692,823.88 lekë.
- ❖ Llogari të arkëtueshme me vlerë 10,188,752 lekë e cila përbëhet nga:
 - Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 23,980,899 lekë shtuar nga viti shkuar me 2,882,568lekë, kjo llogari përfshin detyrime të konstatuara në vitin 2021, kryesisht në dhjetor 2021, detyrime për paga dhe kontribute të punonjësve të cilat, do të likujdohen nga fondet e buxhetore në vitin 2022.
 - Të tjera aktive afashkurtra me me vlerë 11,377,456 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me vlerë 11,377,456 lekë shtuar nga viti shkuar me 11,377,456 lekë përbëhet nga:

Llogaria kontabël e detyrimit	Tipologjia e detyrimeve financiare	Vlera
4031000	Kontratë marrje automjete me qera 25.03.2021-25.01.2024 (Nr. 77959 ne SIFQ)	5,532,240
4031000	Kontrate shërbim pastrimi i zyrave dhe ambienteve te ILD 08.04.2021-08.03.2022 (Nr.76119 ne SIFQ)	372,438
4031000	Kontrate Shërbim i ruajtjes dhe sig. fizike te objektit 21.12.2021-20.12.2022 (Nr.79814 ne SIFQ)	5,108,978
4031000	Kontrate shërbim interneti 27.01.2021-27.01.2022	39,800
4031000	Kontrate abonim vjetor 25.11.2021-25.11.2022 ne cloud per financën	324,000
Teprica e angazhimeve me 31.12.2021		11,377,456

Burimi: Të dhëna të ILD

Detyrime që vijnë nga kontratat e lidhura mbi ofrimin e shërbimit ndaj institucionit (angazhime financiare).

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 573,930,983.78 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “investime”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- ❖ Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 569,860,983.78 lekë shtuar nga viti i shkuar me 551,999,267 lekë përbëhet nga:
 - Llogaria 212 Ndërtesa e Konstruksione me vlerë 547,925,100 lekë shtuar nga viti i shkuar me 547,925,100 lekë.
 - Llogaria 215 Mjete Transporti me vlerë 7,316,053.12 lekë shtuar nga viti i shkuar me 5,693,486.72 lekë.

Për vitin raportues, institucioni i ILD ka patur ne dispozicion 4 automjete, nga te cilët:

1 (një) Automjet i hyrë në vitin 2020 me transferim pa pagesë nga Avokatura e Shtetit, me vlerë fillestare 2,507,400 lekë

1 (një) Automjet i blerë me buxhetin e miratuar për vitin 2021 me çmimin 7,080,000 lekë

2 (dy) Automjete të hyrë në institucion (pa çmimi), sipas kontratës së shërbimit të marrjes me qera nr. 540/7, dt. 25.03.2021

Dy mjetet e hyra me qira nuk janë përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2021.

- Llogaria 218 Inventar Ekonomik me vlerë 14,619,830.66 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 1,619,319.2 lekë.

Gjatë vitit 2021 Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë ka patur shtesa në vlerën 5,639,966 lekë dhe pakësime në vlerën 7,172,117 lekë në llogarinë 218 Inventar Ekonomik.

❖ Shtesat gjatë vitit 2021

- Shkresa nr. 2979 prot., datë 07.05.2021 Urdhër i Përbashkët me Departamentin e Administratës Publike “Transferimin kapital pa pagesë të aktiveve nga Departamenti i Administratës Publike tek Zyra e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë”. Departamenti i Administratës Publike ka urdhëruar transferim kapital pa pagesë të aktiveve në vlerën 6,215,745 lekë nga të cilat 4,504,349 rikonstruksion godine dhe 1,711,396 lekë (1,090,026 lekë tavolina, 259,300 lekë karrige dhe 42,070 lekë sirtariera) ku ka bashkangjitur edhe listën me përshkrim, sasi dhe çmim për secilin aktiv. Kalimi ka të bashkangjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të përlllogaritur nga ILD deri në momentin e daljes nga pronësia.

- Marrëveshje e transferimit të asetëve, e lidhur më datë 28.04.2021 midis Projektit EURALIUS V “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri” dhe Zyrës së Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë. Donatori i ka dhuruar institucionit kamera interneti, server, Firewall, UPS dhe licenca (Abonim vjetor në Microsoft Office) në vlerën totale 1,028,436 lekë si më poshtë:

Aktive afatgjatë (server, ups, firewall) në vlerën 878,170 lekë

Materiale inventari (Webcam) në vlerën 144,000 lekë

Shërbime (Microsoft Office) në vlerën 6,266 lekë

- Blerje gjatë vitit 2021

Blerje më datë 25.05.2021 në vlerën 2,852,400 (UPS, Servera)

Blerje më datë 26.07.2021 në vlerën 198,000 (Kondicionerë, frigorifer)

❖ Pakësime gjatë vitit 2021

- Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë në shkresën nr. 1699 prot., datë 12.03.2021 me Urdhër të Përbashkët me Departamentin e Administratës Publike “Për transferimin kapital pa pagesë të aktiveve nga Zyra e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë tek Departamenti i Administratës Publike” ka urdhëruar transferim kapital pa pagesë të aktiveve në vlerën 7,172,117 lekë, ku ka bashkangjitur edhe listën me përshkrim, sasi dhe çmim për secilin aktiv. Po ashtu nga grupi auditues u konstatua se kalimi ka të bashkangjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të përlllogaritur nga ILD deri në momentin e daljes nga pronësia.

Veprimet e mësipërme janë kryer referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 55...“Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues”.

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, aktivet afatgjata materiale janë pasqyruar me vlerën neto (kosto historike minus amortizimin e akumuluar). Normat për amortizimin e aktiveve, janë

aplikuar sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 09.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me metodën e vlerës së mbetur përgjatë jetës ekonomike.

❖ Llogaria 230- 231 “Investime” me vlerë totale prej 4,070,000 lekë shtuar nga viti i shkuar me 3,960,000 lekë përbëhet nga:

- Llogaria 231 “Për Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë 4,070,000 lekë shtuar nga viti i shkuar me 3,960,000 lekë:

në lekë

Nr	Përshkrimi	Llog. Ekonomike	Gjendja 01.01.2021	Shtesa 2021	Pakësime 2021	Gjendja 31.12. 2021
1	Detyre projektimi për rikonstruksionin e ambienteve te godinës se ILD	2312101	110,000			110,000
2	Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e ambienteve te godinës se ILD	2312101		3,960,000	-	3,960,000
	TOTALI		110,000	3,960,000	-	4,070,000

Burimi: Të dhëna të ILD

Pasivi

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2022, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

B	PASIVET(DETYRIMET)	21,566,208.00	7,306,184.00
	IPasivet Afat shkurtra	21,566,208.00	7,306,184.00
	1. Llogari te Pagushme	21,566,208.00	7,306,184.00
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	13,212,278.00	1,263,971.00
42	Detyrime ndaj personelit	5,740,932.00	4,195,386.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	746,070.00	533,756.00
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime Shoqërore	1,619,590.00	1,135,399.00
436	Sigurime Shëndetësorë	247,338.00	177,672.00
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	578,841,520.55	19,361,691.10
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	578,841,520.55	19,361,691.10
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	569,860,983.78	17,861,716.29
12	Rezultatet e mbartura	1,389,974.81	
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	3,520,561.96	1,389,974.81
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshmne	4,070,000.00	110,000.00
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	600,407,728.55	26,667,875.10

Burimi: Të dhëna të ILD

Pasivi (Detyrimet)

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë shtuar në krahasim me një vit më parë me 14,260,024 lekë. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të pasiveve (detyrimeve) afatshkurtra dhe pasqyrohet në vlerën

21,566,208 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Llogari të Pagueshme”, “Detyrime ndaj personelit”, “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” dhe “Det. ndaj shtetit për tatim taksa”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- ❖ “Llogari të Pagueshme” me vlerë totale prej 21,566,208 lekë shtuar nga viti i shkuar me 14,260,024 lekë përbëhet nga:
 - Llogaria 401-408 “Furnitore dhe llogari te lidhura me to” me vlerë 13,212,278 lekë shtuar nga viti i shkuar me 11,948,307 lekë
 - Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” me vlerë 5,740,932lekë shtuar nga viti i shkuar me 1,545,546 lekë
 - Llogaria 431 “Det. ndaj shtetit për tatim taksa” me vlerë 746,070 lekë shtuar nga viti i shkuar me 212,314 lekë
 - Llogaria 435- 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” me vlerë 1,866,928 lekë shtuar nga viti i shkuar me 553,857 lekë
- ❖ Llogaritë 101 “*Teprica (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar*”, në vlerën 569,860,983.78 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)

Mbi të ardhurat:

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 124,759,407 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 121,238,845.04 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = -3,520,561.96 lekë

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 3,520,561.96 lekë, vlerë e cila rakordon me llogarinë 85 në vlerën 3,520,561.96.

Mbi shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2021.

-Llogaria (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 3,520,561.96 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve, evidentuar në Formatin nr.2, për -3,520,561.96 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “*Gjendja e inventarit*” në aktivin e bilancit ku (1,389,974.81 lekë -4,910,536.77 lekë= -3,520,561.96 lekë)

Inventarizimi

Më datë 12.01.2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka zhvilluar procesin e inventarizimit të aktiveve të saj. Në zbatim të Urdhërit nr. 165, datë 24.12.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit, komisioni i ngarkuar për inventarizimin e aktiveve në administrim të njësisë, ka realizuar këtë

proçes, në datat 05.01.2022 deri në datën 07.01.2022. Fletët e inventarit të aktiveve në përdorim dhe të aktiveve gjendje në magazinën e institucionit, me informacionin sipas gjendjes kontabël në datën 31.12.2021 janë marr në dorëzim nga NA znj. V.K.. Komisioni ka arritur në përfundimin se për aktivet e inventarizuara:

- Nuk ka diferenca dhe dëmtime fizike të aktiveve dhe materialeve dhe se janë në gjendje cilësore dhe funksionale.
- Nuk ka diferenca midis të dhënave kontable të aktiveve dhe të dhënave të librave të magazinës që mbahen nga punonjësi me përgjegjësi materiale.

në lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera sipas të dhënave kontabël (ne leke)	Vlera sipas inventarizimit fizik (ne leke)	Diferenca t (+/-)
1	Aktive afatgjatë në përdorim ne zyrat dhe mjediset e punës	27,425,924.00	27,425,924.00	0
2	Aktive afatgjate në inventarin personal të punonjësve	5,944,080.00	5,944,080.00	0
3	Inventar i imët ne përdorim	606,354.48	606,354.48	0
4	Aktivt e afatgjate gjendje në magazinë	1,956,716.00	1,956,716.00	0
5	Materiale dhe artikuj obj. inventarizimi në magazinë	4,304,182.29	4,304,182.29	0
6	Automjete	9,587,400.00	9,587,400.00	0
7	Ndërtesa ILD (vlera e rikonstruksionit dhe aktivt e instaluar në godinë)	548,246,400.00	548,246,400.00	0
	Totali	598,071,056.77	598,071,056.77	0

Burimi: Të dhëna të ILD

Nga auditimi i dosjeve të inventarit u konstatua se para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal më datë 07.01.2022ku është fiksuar numri rendor nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material (magazinerit) dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky referuar me pikën 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citohet ... "Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve nëpërdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2021:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 1** "Pasqyra e pozicionit"

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 600,407,728.55 lekë në vitin 2021;

- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 2** "Pasqyra e performancës"

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr. 2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 3,520,561.96 lekë (124,759,407- 121,238,845.04). Pra totali në *pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit* (formatet 2), në shumën 3,520,561.96 lekë;

- Llogaria 63 “*Ndryshim i gjendjeve të inventarit*”, evidentuar në Formatin nr.2, për 3,520,561.96 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “*Gjendja e inventarit*” në aktivin e bilancit ku (4,910,536.77 lekë- 1,389,974.81 lekë= - 3,520,561.96 lekë)

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 3 “Pasqyra e cash flow”* kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”* kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Shtesat kanë ndodhur si rezultat i shpenzimeve për investime të kryera nga fondet buxhetore. Pakësimet kanë ardhur si rezultat i konsumit vjetor të AAM dhe transfertave brenda sistemit.

Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 578,841,520.55 lekë.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.5 “Shënimet shpjeguese”*, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- ❖ informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të varësisë,etj);
- ❖ informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
- ❖ informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.6 “Investimet dhe Burimet e financimit”*. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për këtë institucion është 4,070,000 lekë.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7/a*, paraqet gjendjen e aktiveve me dt. 31.12.2022, si rezultat i shtesave nga blerjet e kryera dhe shtesave pa pagesë jashtë sistemit, si dhe pakësimeve për furnizimet brenda sistemit, daljet e aktiveve gjatë vitit ushtrimor.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7/b* “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore,

për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin, teprica neto në vlerën 569,860,984 lekë (Kosto Historike 593,160,520 lekë – Amortizim i akumuluar 23,299,536 lekë) -*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”,* siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Mbyllja e bilancit për vitin 2022 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar por duhen sistemuar llogaritë e përmendura më lart.

Pasqyra financiare viti 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ”.

Pasqyrat Financiare të raportimit për vitin 2022, përmbajnë:

- Pozicioni Financiar (Formati Nr.1).
- Performanca Financiare (Formati nr.2).
- Pasqyra e Cash Flow (Formati nr.3).
- Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto (Formati nr.4).
- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. (Formatet nr. 5).

Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore, të cilat janë:

- Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre (Formati nr. 6).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (Formati nr. 7).
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave (Formati nr. 8).

Veprimet për vitin 2022 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

- *Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.*

Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2022 i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Degës së Thesarit me shkresën nr. 955 prot., datë

27.03.2022, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, në referim të paragrafit nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018. Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2022, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E m ë r t i m i	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	706,559,986.42	600,407,728.55
2		I.Aktivet Afat shkurtra	141,663,450.01	26,476,744.77
3		2.Gjendje Inventari qarkullues	3,981,965.02	4,910,536.77
4	31	Materiale	2,913,081.94	4,122,516.89
5	32	Inventar i imët	1,068,883.08	788,019.88
6		3.Llogari te Arkëtueshme	23,980,899.00	10,188,752.00
7	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	23,980,899.00	10,188,752.00
8		4.Të tjera aktive afatshkurtra	113,700,585.99	11,377,456.00
9	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	113,700,585.99	11,377,456.00
10		II.Aktivet Afat gjata	564,896,536.41	573,930,983.78
11	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	1,881,513.00	-
12	203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme	1,881,513.00	
13	21	2.Aktive Afatgjata materiale	547,287,562.41	569,860,983.78
14	212	Ndërtesa e Konstruksione	520,528,844.98	547,925,100.00
15	215	Mjete Transporti	5,955,066.06	7,316,053.12
16	218	Inventar ekonomik	20,803,651.37	14,619,830.66
17		4.Investime	15,727,461.00	4,070,000.00
18	231	Për Aktive Afatgjata materiale	15,727,461.00	4,070,000.00

Burimi: Të dhëna të ILD

Zëri Aktive

Shuma e aktivitetit të pasqyrës financiare pasqyron aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitetit të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2022,rezultojnë se totali i aktivitetit me 31.12.2022 paraqitet me vlerën 706,559,986.42 lekë dhe se “Aktive Afatgjata”, zënë rreth 80 % të vlerës totale të aktivitetit ndërsa Aktivet Afatshkurtra zënë 20 % të vlerës totale. Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2021, janë pakësuar në vlerën 9,034,447 lekë ndërsa, Aktivet Afatshkurtra janë shtuar në vlerën 115,186,705.24 lekë.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues”, “Llogarive të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- ❖ Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 3,981,965.02 lekë.

Totali i llogarisë “Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 928,571.75lekë nga viti i shkuar 2021. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën e performancës, e cila rezulton në vlerën 928,571.75 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 2,913,081.94 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 1,209,434.95 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2022, materiale kancelarie si: letër, tonera, furnizime e materiale të tjera zyre e të përgjithshme, etj.
- Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 1,068,883.08 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 280,863.2 lekë.
- ❖ Llogari të arkëtueshme me vlerë 23,980,899 lekë e cila përbëhet nga:
 - Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 23,980,899 lekë shtuar nga viti shkuar me 13,792,147lekë, kjo llogari përfshin detyrime të konstatuara në vitin 2022, kryesisht në dhjetor 2022, detyrime për paga dhe kontribute të punonjësve, të cilat, do të likujdohen nga fondet e buxhetore në vitin 2023.
 - Të tjera aktive afashkurtra me me vlerë 113,700,585.99 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave të ardhshme” me vlerë 113,700,585.99 lekë shtuar nga viti shkuar me 102,323,130 lekë.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata (kosto historike minus amortizimin e akumuluar) dhe pasqyrohet në vlerën 564,896,536.41 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “investime”

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

- ❖ Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 1,881,513 lekë shtuar nga viti i shkuar me 1,881,513 lekë përbëhet nga:
 - Llogaria 203 Koncesione, Patenta, Licenca me vlerë 1,881,513 lekë shtuar nga viti shkuar me 1,881,513 lekë
- ❖ Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 547,287,562.41 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 22,573,422 lekë përbëhet nga:
 - Llogaria 212 Ndërtesa e Konstruksione me vlerë 520,528,844.98 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 27,396,256 lekë nga llogartja e amortizimit.
 - Llogaria 215 Mjete Transporti me vlerë 5,955,066.06 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 1,360,987.06 lekë.

Për vitin raportues, institucioni i ILD-së ka patur në dispozicion 4 automjete, nga të cilët:

1 (një) Automjet i hyrë në vitin 2020 me transferim pa pagesë nga Avokatura e Shtetit, me vlerë fillestare 2,507,400 lekë

1 (një) Automjet i blerë me buxhetin e miratuar për vitin 2021 me çmimin 7,080,000 lekë

2 (dy) Automjete të hyrë në institucion (pa çmimi), sipas kontratës së shërbimit të marrjes me qera nr. 540/7, dt. 25.03.2021.

- Llogaria 218 Inventar Ekonomik me vlerë 20,803,651.37 lekë shtuar nga viti i shkuar me 6,183,820.7 lekë

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, aktivet afatgjata materiale janë pasqyruar me vlerën neto (kosto historike minus amortizimin e akumuluar).

Normat për amortizimin e aktiveve, janë aplikuar sipas Udhëzimit Nr. 8, datë 09.03.2018, të

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me metodën e vlerës së mbetur përgjatë jetës ekonomike.

❖ Llogaria 230- 231 “Investime” me vlerë totale prej 15,727,461 lekë shtuar nga viti i shkuar me 11,657,461 lekë përbëhet nga:

- Llogaria 231 “Për Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë 15,727,461 lekë shtuar nga viti i shkuar me 11,657,461 lekë:

në lekë

Nr	Përshkrimi	Llog. Ekonomike	Gjendja me 01.01.2022	Shtesa 2022	Pakësim e 2022	Gjendja me 31.12. 2022
1	Detyrë projektimi për rikonstruksionin e ambienteve të godinës së ILD	2312101	110,000			110,000
2	Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e ambienteve të godinës së ILD	2312101	3,960,000		-	3,960,000
3	Pagesë 10% paradhënie sipas Kontratës nr.1773/8 dt.30.12.2022 për rikonstruksionin e godinës	2312101		11,657,461	-	11,657,461
	TOTALI		4,070,000	11,657,461	-	15,727,461

Burimi: Të dhëna të ILD

Pasivi

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2022, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

B	PASIVET(DETYRIMET)	137,681,484.99	21,566,208.00
	I.Pasivet Afat shkurtra	23,980,899.00	21,566,208.00
	1. Llogari të Pagueshme	23,980,899.00	21,566,208.00
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	12,869,782.00	13,212,278.00
42	Detyrime ndaj personelit	7,740,535.00	5,740,932.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	901,106.00	746,070.00
435	Sigurime Shoqërore	2,169,609.00	1,619,590.00
436	Sigurime Shëndetësorë	299,867.00	247,338.00
	II.Pasivet Afat Gjata	113,700,585.99	-
Klase 4	Llogari të pagueshme	113,700,585.99	
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	568,878,501.43	578,841,520.55
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	568,878,501.43	578,841,520.55
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	549,169,075.41	569,860,983.78
12	Rezultatet e mbartura	4,910,536.77	1,389,974.81
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	-	3,520,561.96
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	15,727,461.00	4,070,000.00
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	706,559,986.42	600,407,728.55

Burimi: Të dhëna të ILD

Pasivi (Detyrimet)

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë shtuar në krahasim me një vit më parë me 116,115,276 lekë. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të pasiveve (detyrimeve) afatshkurtra dhe pasqyrohet në vlerën 564,896,536.41 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Llogari të Pagueshme”, “Detyrime ndaj personelit”, “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” dhe “Det. ndaj shtetit për tatim taksa”.

“Llogari të Pagueshme” me vlerë totale prej 23,980,899 lekë shtuar nga viti i shkuar me 2,414,691 lekë përbëhet nga:

- Llogaria 401-408 “Furnitore dhe llogari te lidhura me to” me vlerë 12,869,782 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 342,496 lekë
- Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” me vlerë 7,740,535 lekë shtuar nga viti i shkuar me 1,999,603 lekë.
- Llogaria 431 “Det. ndaj shtetit për tatim taksa” me vlerë 901,106 lekë shtuar nga viti i shkuar me 155,036 lekë.
- Llogaria 435- 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” me vlerë 2,469,476 lekë shtuar nga viti i shkuar me 602,548 lekë
- ❖ Pasivet Afatgjata Llogaria “**Llogari të pagueshme**”, në vlerën 113,700,585.99 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 113,700,585.99 lekë.

Konstatim:

- ❖ Llogaritë 101 “**Teprica (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar**”, në vlerën 549,169,075.41 lekë. Këto fonde nuk i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit e cila sipas paraqitjes rezulton të jetë në vlerën 547,287,562.41 lekë.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)

Mbi të ardhurat:

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” nuk është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Konkretisht për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 141,990,371 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 142,918,942.75 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 928,571.75 lekë

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 928,571.75 lekë, vlerë e cila rakordon me llogarinë 85 në vlerën 928,571.75.

Mbi shpenzimet:

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2022.

-Llogaria (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 928,571.75 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve, evidentuar në Formatin nr.2, për 928,571.75 lekë, rakordon me

ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit ku (3,981,965.02 lekë- 4,910,536.77 lekë= -928,571.75 lekë).

Inventarizimi

Më datë 10.01.2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka zhvilluar procesin e inventarizimit të aktiveve të saj. Në zbatim të Urdhërit nr. 106, datë 13.12.2022 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit”, komisioni i ngarkuar për inventarizimin e aktiveve në administrim të njësisë, ka realizuar këtë proces, në datat 04.01.2023, 05.01.2023 dhe 06.01.2023. Fletët e inventarit të aktiveve në përdorim dhe të aktiveve gjendje në magazinën e institucionit, me informacionin sipas gjendjes kontabël në datën 31.12.2022 janë marr në dorëzim nga NA znj. V. K. Komisioni ka arritur në përfundimin se për aktivet e inventarizuara:

- Nuk ka diferenca dhe dëmtime fizike të aktiveve dhe materialeve dhe se janë në gjendje cilësore dhe funksionale
- Nuk ka diferenca midis të dhënave kontabël të aktiveve dhe të dhënave të librave të magazinës që mbahen nga punonjësi me përgjegjësi material
- Për automjetet në administrim të ILD-së, inventarizimi fizik është kryer mbi verifikimin e gjendjes fizike sipas të dhënave tekniko- inventariale, pa diferenca të elementëve përbërës.

në lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera sipas të dhënave kontabël (në lekë)	Vlera sipas inventarizimit fizik (në lekë)	Diferenca t (+/-)
1	Aktive afatgjatë në përdorim në zyrat dhe mjediset e punës	32,132,536.40	32,132,536.40	0
2	Aktive afatgjate në inventarin personal të punonjësve	9,974,868.46	9,974,868.46	0
3	Inventar i imët në përdorim	683,054.88	683,054.88	0
4	Aktivt afatgjate gjendje në magazinë	5,025,709.55	5,025,709.55	0
5	Materiale dhe artikuj obj. inventarizimi ne magazine	3,298,910.14	3,298,910.14	0
6	Automjete	9,587,400.00	9,587,400.00	0
7	Ndërtesa ILD (vlera e rikonstruksionit dhe aktivet e instaluar në godinë)	548,246,400.00	548,246,400.00	0
	Totali	608,948,879.43	608,948,879.43	0

Burimi: Të dhëna të ILD

Nga auditimi i dosjeve të inventarit u konstatua se para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal më datë 04.01.2023 ku është fiksuar numri rendor mbi fletë hyrjen e fundit dhe fletën e daljes së fundit deri në këtë datë të fillimit të inventarizimit nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material (magazinerit) dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky referuar me pikën 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citohet ... "Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Në dosje janë depozituar kartelat/fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve nëpërdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre,

gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2022:

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 1** “Pasqyra e pozicionit”*

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 706,559,986.42 lekë në vitin 2022;

*- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 2** “Pasqyra e performancës”*

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr. 2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 928,571.75 lekë (141,990,371- 142,918,942.75). Pra totali në *pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit* (formatet 2), në shumën 928,571.75 lekë;

- Llogaria 63 “*Ndryshim i gjendjeve të inventarit*”, evidentuar në Formatin nr.2, për 928,571.75 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “*Gjendja e inventarit*” në aktivin e bilancit ku (3,981,965.02 lekë- 4,910,536.77 lekë= -928,571.75 lekë)

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 3** “Pasqyra e cash flow”* kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.4** “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”* kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Shtesat kanë ndodhur si rezultat i shpenzimeve për investime të kryera nga fondet buxhetore. Pakësimet kanë ardhur si rezultat i konsumit vjetor të AAM dhe transfertave brenda sistemit.

Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 568,878,501.43 lekë.

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.5** “Shënimet shpjeguese”,* japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- ❖ informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të varësisë,etj);
- ❖ informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
- ❖ informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Investimet dhe Burimet e financimit”.* Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për këtë institucion është 4,910,537 lekë.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/a**,* paraqet gjendjen e aktiveve me dt. 31.12.2022, si rezultat i shtesave nga blerjet e kryera dhe shtesave pa pagesë jashtë sistemit, si dhe pakësimeve për furnizimet brenda sistemit, daljet e aktiveve gjatë vitit ushtrimor.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/b** “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)”*, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, *është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin, teprica neto në vlerën 549,169,075.41 lekë (Kosto Historike 606,947,454.38 lekë – Amortizim i akumuluar 57,778,378.97 lekë)*

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”*, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Mbyllja e bilancit për vitin 2022 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar por duhen sistemuar llogaritë e përmendura më lart.

Çertifikatë regjistrimi pronësie

Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka kryer regjistrimin e truallit me sipërfaqe 1415 m² dhe ndërtesën në sipërfaqen 0, në përgjegjësi administrimi të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Akti i Fitimit të Pronësisë: VKM “Për kalimin në Përgjegjësi Administrimi, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish- Ministrisë së Integritimit Evropian”, nr. 507, datë 24.06.2020, regjistruar: nr. 24189, datë 01.07.2022.

Agjencia Shtetërore e Kadastër ka kryer regjistrimin e truallit me sipërfaqe 828 m² dhe ndërtesën në sipërfaqen 121.5 m². Akti i Fitimit të Pronësisë: VKM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/ apo vendimet e shpronësimit), nr. 507, datë 24.06.2020, regjistruar: nr. 24189, datë 17.01.2023.

Grupi i auditimit përzgjedhi disa nga Urdhër Shpenzimet, të cilat u verifikuan se janë paguar brenda afatit ligjor dhe kanë të bashkangjitura këto dokumenta:

U.SH. nr. 375, datë 08.11.2022 “Blerje pajisje IT”, vlera me TVSH 1,753,200 lekë (Dok. për procedurën e prokurimit, Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal marrje në dorëzim, Fletë Hyrje)

U.SH. nr. 357, datë 28.10.2022 “Shërbim Përkthimi”, Blerje me vlerë 10,000 lekë (pa TVSH) (Dok. për procedurën e ndjekur për vlerat nën 100,000 lekë, Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal për shërbimin)

U.SH. nr. 299, datë 19.09.2022 “Shërbim pastrimi i zyrave dhe ambienteve të ILD-së 08.08.2022- 07.09.2022” me vlerë 98,182 lekë, (Memo, Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal për shërbimin)

U.SH. nr. 279, datë 07.09.2022 “Shërbim i ruajtjes të objektit 01.07.2022- 31.07.2022” me vlerë 425,748 lekë (Memo, Fat. Elektronike tatimore, Relacion për kryerjen e shërbimit)

U.SH. nr. 274, datë 07.09.2022 “Shërbim i marrjes me qera të automjeteve 26.06.2022- 25.07.2022” me vlerë 224,280 lekë (Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal për shërbimin) (paguar me vonesë për shkak të kthimit nga thesari)

U.SH. nr. 247, datë 05.08.2022 “Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca” me vlerë 4,244,654 lekë (Memo, Kërkesë për bashkëpunim, Urdhër ILD, Akt marrëveshje, Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal për shërbimin)

U.SH. nr. 206, datë 06.07.2022 “Materiale kancelarie” me vlerë 410,400 lekë (Dok. për procedurën e prokurimit, Fat. Elektronike tatimore, Procesverbal marrje në dorëzim, Fletë Hyrje)

2.4. “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet sa më poshtë vijon:

Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.

1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Strukturat përgjegjëse të Zyrës së ILD, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji.

Mjedisi i kontrollit vlerësohet bazuar në komponentët si më poshtë;

1.1 Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike.

Nga ana e strukturave përgjegjëse është hartuar Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së ILD-së, e miratuar me urdhrin nr. 119/2021, datë 12.7.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e ndryshuar. Rregullorja është e aksesueshme në faqen zyrtare të ILD-së, në linkun vijues: <https://ild.al/ep-content/uploads/2021/09/Urdher-nr.119-date-12.07.2021-per-miratimin-rregullores-se-brendshme.pdf>.

ILD–jaka një Kod Etike të miratuar me Urdhrin nr.56 të datës 07.07.2022 (i cili shfuqizon Urdhrin nr. 71 datë 01.10.2020 “Mbi rregullat e sjelljes dhe standardet e etikës në zyrën ILD”), si dhe ka procedurën për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara e cila është e bazuar në ligjin 153/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit sipas përcaktimeve të nenit 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” të Ligjit 10926 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 ku përcaktohet se “Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i

njesisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Gjithashtu institucioni ka miratuar me urdhrin nr.102 datë 14.06.2021” Për miratimin e rregullores për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;

Konstatohet se ILD-ja ka hartuar planet strategjike 2020-2022 dhe 2023-2025, me anë të shkresave nr. 2907 datë 01.12.2020 dhe nr. 3410 datë 20.12.2023, të cilat përmbajnë objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritare të institucionit si dhe ka përgatitur planet e masave dhe veprimet në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre, sipas përcaktimeve në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a.

ILD për periudhën e auditimit, ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) me vendimin nr.59 datë 21.09.2020 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik” i ndryshuar me vendimin nr.120 datë 14.07.2021 “Për një ndryshim në urdhrin nr.59”. Me vendimin nr.144 datë 03.11.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik” u ngrit GMS me përfshirjen e përfaqësuesit të inspektorit dhe përfaqësuesit të ndihmës inspektorit.

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit është Nëpunësi Autorizues, sipas shkresës nr.3153/1 prot., datë 12.07.2021.

Punonjësit e ILD-së, marrëdhëniet e punës me punëdhënësin i rregullojnë në bazë të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa i përket delegimit të kompetencave, konstatohet se *ILD ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre*, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative, në nenin 15 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar si dhe Kap. III “Delegimi i Detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Me urdhrin nr.123 datë 28.07.2021 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative që dalin nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” botuar edhe në fletoren zyrtare nr.123 datë 04.08.2021, i është deleguar kompetenca e nënshkrimit të dokumenteve administrative të listuara në urdhër.

1.3 Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Struktura organizative e ILD-së është miratuar me anë të Vendimit nr.28/2020, datë 18.06.2020 nga Kuvendi, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe në nenet 197, pika 4 dhe 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar me numër total punonjësish **93**.

Kjo strukturë është ndryshuar me Vendimin nr. 85/2020, për miratimin disa ndryshimeve në Vendimin nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të ILD dhe së fundmi funksionon sipas Vendimit nr. 10/2023, datë 16.02.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 28/2020, ku struktura organizative ka një numër të përgjithshëm të punonjësve prej **101**.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2021-2023, ILD ka funksionuar me strukturë jo të plotë,

duke pasur vende vakante të lira, kjo jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me vendim të Kuvendit.

Konkretisht;

Për vitin 2021 struktura ka funksionuar me 72.92 %, të përbërjes së saj me një numër mesatar prej 73 punonjësish me pozicione vakante si më poshtë:

- 1 Këshilltar
- 9 Inspektor Magjistratë
- 9 Inspektor jo Magjistratë
- 1 Drejtor i Përgjithshëm
- 2 Ndihmës Inspektor
- 1 Përgjegjës Sektori
- 4 Specialist
- 1 Punonjës mbështetës (shofer)

Për vitin 2022 struktura ka funksionuar me 76.58 %, të përbërjes së saj me një numër mesatar prej 78 punonjësish me pozicione vakante si më poshtë:

- 1 Këshilltar
- 9 Inspektor Magjistratë
- 5 Inspektor jo Magjistratë
- 1 Drejtor i Përgjithshëm
- 1 Ndihmës Inspektor
- 1 Përgjegjës Sektori
- 3 Specialist
- 1 Punonjës mbështetës (shofer)

Për vitin 2023 struktura ka funksionuar në 82.16 % të përbërjes së saj me një numër mesatar prej 86 punonjësish me pozicione vakante si më poshtë:

- 1 Sekretar në Kabinet
- 7 Inspektor Magjistratë
- Inspektor jo Magjistratë
- 1 Ndihmës Inspektor
- 1 Drejtor drejtorie
- 1 Përgjegjës Sektori
- Specialist
- 1 Punonjës mbështetës (shofer)
- 1 Punëtor Mirëmbajtje

Mungesa në strukturën organizative ndikon në performancën e njësisë, duke rrezikuar përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ILD-ja ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, hyrjen dhe qëndrimin në mjediset e punës etj, sipas përcaktimeve në nenin 20, të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010. Nga institucioni rezultojnë të jetë bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Konstatohet se për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të

punonjësve, në ILD ka plan veprimi për trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, të cilat realizohen sipas nevojave, konkretisht me shkresat nr.2932/1 datë 08.10.2021, nr.2983/1 datë 04.11.2022 dhe nr.3160/1 datë 13.11.2023.

Grupi i auditimit konstaton se janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ)** për Zyrën e ILD-së, *si vijon*:

Caktimi i nëpunësit autorizues dhe zbatues është kryer rregullisht referuar korrespondencave shkresore të mbajtura me institucionin e MFE.

- Caktimi i nëpunësit autorizues është bazuar në aktin e emërimit nr. 2601/6 datë 09.07.2021 ku znj.D. P. sipas vendimit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit emërohet Sekretar i Përgjithshëm pranë Zyrës së ILD-së. Sipas Vendimit nr. 46, datë 12.07.2021 “Për fillimin e marrëdhënieve financiare për znj.D. P.”, të ILD-së dhe shkresës nr. 3153/1 datë 12.07.2021 dërguar MFE, është kërkuar konfirmimi i Sekretarit të Përgjithshëm në pozicionin e NA. Konfirmimi si Nëpunës Autorizues për znj.D.P është dhënë sipas shkresës nr. 12784/1 datë 30.07.2021 të MFE.
- Me shkresën nr. 2783 prot, datë 18.11.2020 të ILD-së i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Degës së Thesarit Tiranë, ***caktimi i Nëpunësit Zbatues*** znj.V.K. Sa sipër, me shkresën e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit dhe nr. 21684/1 prot, datë 01.12.2020 është konfirmuar znj.V.K. si Nëpunëse Zbatuese e institucionit , me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse.
- Me shkresën nr. 2205 prot, datë 06.07.2023 të ILD i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Degës së Thesarit Tiranë, ***caktimi i Nëpunësit Zbatues*** znj.S.R., me detyrë përgjegjës i sektorit të buxhetit dhe financës.

2. Menaxhimi i riskut.

ILD ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, me anë të urdhrin nr.146 datë 29.12.2023 “Për miratimin e strategjisë së riskut dhe të planit të veprimit për minimizimin e risqeve në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, konstatohet se njësia ka përcaktuar NA znj. D.P. me anë të shkresës nr.3153/1 datë 12.07.2021, e cila sipas Manualit të MFK-së (pika 3.2 Menaxhimi i riskut) përgjigjet dhe për zbutjen e risqeve të njësisë, këto sipas përcaktimeve në nenin 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe nenin 21, pika 2 “Menaxhimi i riskut”.

Gjithashtu është ngritur edhe grupi i menaxhimit të riskut me urdhrin nr.146 datë 29.12.2023 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut”.

3. Aktivitetet e kontrollit.

ILD-ja ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit me anë të Urdhrin nr. 168, datë 29.12.2021, “Për miratimin e gjurmëve standarte të auditimit për zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” për procese të tilla si menaxhimi i aktiveve, procedura e marrjes në dorëzim, inventarizimi fizik i aktiveve, shpërndarja e fondeve buxhetore, ekzekutimi i shpenzimeve, mbi miratimin e planin vjetor sipas përcaktimit në nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditit” dhe nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ”.

4. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të ILD-së si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet kryesisht me anë të postës elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt

me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Nga kërkimi i ndërveprimit të ILD me qytetarët, konstatohet se institucioni ka një faqe web ku përmban edhe nënseksion ku pasqyrohet programi i transparencës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit' ku në nenin 4 përcaktohet se "Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni". Gjithashtu është i pasqyruar koordinatori për të drejtën e informimit.

5. Monitorimi

Për periudhën e audituar, konstatohet se ILD ka plotësuar pyetëtorët e vetëvlerësimit në zbatim të formatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK si dhe ka një sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave sipas përcaktimeve në nenin 24, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010.

- ✓ Me shkresën nr.448/3 datë 25.02.2022 për **vitin 2021** është dërguar Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e SKB për vitin 2021, pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar sipas përcaktimeve të Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 224 datë 16.12.2021 "Për disa ndryshime dhe një shtesë në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit".
- ✓ Me shkresën nr.3350/3 datë 27.02.2022 për **vitin 2022** është dërguar Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e SKB për vitin 2022, pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar sipas përcaktimeve të Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 224 datë 16.12.2021 "Për disa ndryshime dhe një shtesë në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit".
- ✓ Me shkresën nr.3355/4 datë 23.02.2022 për **vitin 2023** është dërguar Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e SKB për vitin 2023, pyetëtori i vetëvlerësimit, plani i veprimit të MFK i plotësuar sipas përcaktimeve të Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 224 datë 16.12.2021 "Për disa ndryshime dhe një shtesë në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit".

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me strukturë organizative të paplotësuar referuar vendimit nr.28/2020, datë 18.06.2020 të Kuvendit, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe në nenet 197, pika 4 dhe 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, edhe pse nga ana e strukturave përgjegjëse të ILD -së janë kryer rregullisht procedurat e shpalljes së vendeve vakante. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 43-47 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për shkak të rëndësisë së posaçme që i njëjti ligji për shtetin e së drejtës si dhe për numrit të madh të çështjeve të backlogut të ankesave ende të pashqyrtuara që arrijnë në 2459 ankesa, deri më 31.12.2023, të marrë masat e nevojshme për

plotësimin e strukturës organizative, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe rritjen e performancës në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë zbatimit të buxhetit janë realizuar disa ndryshime tek zërat buxhetorë të lidhura me investimet që sipas periudhave janë si vijon:

- për vitin 2021 janë planifikuar investimet në vlerën 52,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 23,700 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 14,090 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 59 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 27 %
- për vitin 2022 janë planifikuar investimet në vlerën 64,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 16,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 15.391.2 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 96.2 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 24 %
- për vitin 2023 janë planifikuar investimet në vlerën 73,000 mijë lekë, në planin e rishikuar vlera arrin 36,000 mijë lekë dhe investime të realizuara në vlerën 5,890.8 mijë. Të realizuara kundrejt planit të rishikuar janë në masën 16.4 % ndërsa kundrejt planifikimit fillestar 8 %, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 17-26 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të merren masat e nevojshme si dhe të ndiqen nga ana e strukturave përgjegjëse të kësaj Zyre, të gjitha fazat e procesit buxhetor, të lidhura me përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit; zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit; si dhe kontrollin, kontabilitetin, raportimin dhe auditimin e buxhetit, me qëllim që devijimet e treguesve të realizimit faktik të buxhetit kundrejt treguesve të planifikuar të jenë sa më të vogla dhe të argumentuara, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta të zërave të planit buxhetor gjatë vitit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2023 lidhur me inventarizimin e aktiveve pavarësisht se është miratuar urdhri “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit” për vitin 2021, me nr. 165, datë 24.12.2021 dhe për vitin 2022 me nr. 106 datë 13.12.2022 nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e pikës 73 dhe 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve” pasi nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit përse i përket aktiveve afatgjatë të transferuara nga ish Ministrisë së Integritimit Evropian, të cilat vetëm janë evidentuar në fletët e inventarizimit të përpiluara nga sektori i buxhetit dhe financës, vetëm në sasi, pa vlerë fillestare. Ndërsa nga auditimi u konstatua se në mbyllje të vitit 2023 nuk është realizuar procesi i inventarit fizik sipas afateve ligjore. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 26-42 të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të marrin masat e nevojshme për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit fizik periodik. Komisioni i

inventarizimit në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të marrë masa mbi inventarizimin e aktiveve afatgjatë të transferuara nga ish Ministria e Integritit Evropian, duke kryer evidentimin e aktiveve në sasi dhe në vlerë evidentohen jo vetëm në sasi, por edhe me vlerë si dhe të vlerësojë gjendjen e tyre në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

Në vijimësi

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSE**ANEKS VITI 2021**

Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës) 2021

Mbi të ardhurat:

Nr. rreshti	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c		
1	A	TE ARDHURAT	124,759,407.00	40,226,820.00
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	-	-
3	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	1,090.00	-
4	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	1,090.00	-
5	7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,090.00	
6	72	V.GRANTE KORENTE	124,758,317.00	40,226,820.00
7	720	1.Grant korrent I Brendshëm	124,758,317.00	40,226,820.00
8	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	116,404,387.00	34,174,107.00
9	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	8,353,930.00	6,052,713.00

Mbi shpenzimet

B	SHPENZIMET	121,238,845.04	38,836,845.19
600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	89,981,521.00	31,012,131.00
6001	Paga, personel i përhershëm	86,943,579.00	29,072,629.00
6002	Paga personel i Përkohshëm	3,037,942.00	1,939,502.00
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	13,331,131.00	4,370,014.00
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	11,799,247.00	3,842,440.00
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	1,531,884.00	527,574.00
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	21,221,761.00	4,844,675.00
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	2,089,562.00	2,131,778.00
6021	Materiale dhe shërbime speciale	103,100.00	-
6022	Shërbime nga te trete	10,163,899.00	1,099,763.00
6023	Shpenzime transporti	3,887,279.00	596,304.00
6024	Shpenzime udhëtimi	1,098,120.00	177,250.00
6025	Shpenzime përmirëmbajtje te zakonshme	510,384.00	439,080.00
6026	Shpenzime përqiramarrje	1,749,170.00	-
6029	Shpenzime te tjera operative	1,620,247.00	400,500.00
	V.TRANSFERIME KORENTE	223,904.00	-
606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	223,904.00	-
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	223,904.00	
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	3,520,561.96	- 1,389,974.81
	IX.SHPENZIME TE TJERA	1,090.00	-
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	3,520,561.96	1,389,974.81

ANEKSE VITI 2022

Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës) 2022

Mbi të ardhurat:

Nr. rreshti	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c		
1	A	TE ARDHURAT	141,990,371.00	124,759,407.00
2	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	3,305.00	1,090.00
3	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	3,305.00	1,090.00
4	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	3,305.00	1,090.00
5	72	V.GRANTE KORENTE	141,987,066.00	124,758,317.00
6	720	1.Grant korent i Brendshem	141,987,066.00	124,758,317.00
7	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	131,837,403.00	116,404,387.00
8	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	10,149,663.00	8,353,930.00

Mbi shpenzimet

B	SHPENZIMET	142,918,942.75	121,238,845.04
600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	99,675,589.00	89,981,521.00
6001	Paga, personel i përhershëm	95,708,429.00	86,943,579.00
6002	Paga personel i Përkohshëm	3,967,160.00	3,037,942.00
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	14,765,245.00	13,331,131.00
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	13,068,072.00	11,799,247.00
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	1,697,173.00	1,531,884.00
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	26,306,470.00	21,221,761.00
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	1,179,208.00	2,089,562.00
6021	Materiale dhe shërbime speciale	146,494.00	103,100.00
6022	Shërbime nga te trete	10,978,474.00	10,163,899.00
6023	Shpenzime transporti	719,785.00	3,887,279.00
6024	Shpenzime udhëtimi	4,902,774.00	1,098,120.00
6025	Shpenzime përmirëmbajtje te zakonshme	349,240.00	510,384.00
6026	Shpenzime për qeramarrje	2,761,761.00	1,749,170.00
6029	Shpenzime te tjera operative	5,268,734.00	1,620,247.00
	V.TRANSFERIME KORENTE	1,239,762.00	223,904.00
606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	1,239,762.00	223,904.00
6060	Transferta Të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,239,762.00	223,904.00
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	928,571.75	- 3,520,561.96
	IX.SHPENZIME TE TJERA	3,305.00	1,090.00
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES		
	<i>(Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)</i>	- 928,571.75	3,520,561.96